



MITROVICA
KOMPANIA UJESJELLESË REGIONALE SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOĐ D.O.



KOMPANIA UJESJELLESË SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOĐ D.O.
MITROVICA
TEL: FAX: 080033-797, 520-304
Nr. 01-254/2
Data: 30.07.20

Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare i KRUM Vitin 2019

Vendimi : (01-254/2)

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.07.2020, pas shqyrtimit të Raportit, miratoi njëzëri Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare të KRUM-së për vitin 2019, dhe i njejtë Raport i dërgohet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi: Sami Miftari	Kryesuesi i BtD: Bajram Mustafa
Nënshkrimi		
Data	30.07.2020	30.07.2020



Kompania Rajonale e Ujësjiellit
“ **MITROVICA** ” SH.A.
Mitrovicë

Raport i Audituar financiar

**Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2019**



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

MITROVICA

Kompania Rajonale e Ujësellsit "Mitrovica" SH.A

NUI:810364852


Adresa: Rr "Bislim Bajgora" Pn Mitrovicë

Deklaratë e Pajtueshmërisë

-Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2019-

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2019 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.*

Drejtori Ekzekutiv


(emri, mbiemri, nënshkrimi)

Drejtori Financiar/Kontabilisti I certifikuar


(emri, mbiemri, nënshkrimi)



KRU "Mitrovica" Sh.a Mitrovicë

LET E MENAXHMENTIT

Gjetjet dhe Rekomandimet e Auditorit

per

Pasqyrat Financiare 2019

Bazuar ne Specifikimet teknike të paraqitura ne Dosjen e tenderite Ndermarrjës KRU "Mitrovica" Sh.a përveq dhenies së Opinionit për Pasqyrat fianciare 2019 të Ndermarrjës conform Standardeve Nderkombetare të Auditimit (SNA) , kemi marrë përgjegjësinë të kryejmë edhe Lete Menaxhmentin (LM) e cila njeherit është pjesë përberse e raportit të Auditorit sipas pikës 1 të 04/L-111 Ligjit për Ndermarrjet Publike.

Ne këtë Lete Menaxhment do të prezentojm gjetjet që nuk vlersohen si materiale ,por qe me shumë janë simosrespektim i parimeve dhe rregulloreve ne disa raste. Krahas gjetjeve ne kemi sqaruar ndikimin e ketyre gjetjeve,pasojat e mundshmes dhe rekomandimin për këto gjetje.

Maj 2020

Rasti 1. Trajtimi i Subvencioneve te pranuar nga Qeveria

Gjetja :Ne tërheqim vëmendjen në Shpalosjen 3.6 të pasqyrave financiare, që te ardhurat e pranuar si subvencione ne bazë të vendimit nr. 3058 dhe vendimeve paraprake ne vitin 2019 MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) per mbulimin e kostove për ujin e prodhuar ,duhet të njihen konform Standardit Nderkombëtar të Kontabilitetit -SNK 20 , paragrafët 29 , 30 dhe 31.

Të hyrat nga subvencionet njejt si edhe grantet qeveritare duhet te njihen dhe trajtohen fillimisht si te hyra te shtyra dhe me pastaj paralelisht duke i njohur si te hyra dhe si shpenzime per kostot e qellimit te subvencionit ne periudhat përkatëse.

Ndikimi: Njohja dhe trajtimi jo ne harmoni siç kërkohet meStandardin Nderkombëtar të Kontabilitetit -SNK 20 Për grantet dhe subvencionet Qeveritare ndikon drejt per se drejti ne prezentimin jo të drejt të pasqyrave financiare duke mbivlersuar të ardhurat.

Rekomandimi: Ne rekomandojmë që Subvencionet dhe grantet e pranuar gjithmonë të njihen dhe trajtohen sipas Standardit Nderkombëtar të Kontabilitetit -SNK 20 , paragrafët 29 , 30 dhe 31.

Komentet e Menaxhmentit:

Rasti 2. Shpenzimet e dhuratave dhe ndihmave solidare

Gjetja e auditorit:

a) Shpenzimet për ndihma të punësuarëve konton k:555=13.200,00 të paguara bazuar në vendimin e Kryeshefit ekzekutiv të datës protokoli 27.05.2019 -01-317 sipas vendimit të BtD nr:01.325 të datës 24.05.2017-protokoli për performancën pozitive të vitit 2016. Mirpo vete fakti se në të njëjtin vendim ceket se në mungesë të mjeteve financiare ka qenë e pamundur që të bëhet ekzekutimi i këtij vendimi me heret. Nënkuptohej se kompania KRU Mitrovica ka pasur, ka dhe do të ketë vështësi financiare për shkak të mosinkasimit të llogarive të arketueshme.

Ndikimi: Paguesa kesh nga arka për ndihme të punësuarëve: 264 x50.00€ :13.200.00€ me këtë shkallë të lartë të mosinkasimit të llogarive të arketueshme ngrihet dhe me lartë shkallën e moslikuiditetit të kompanisë nga njëra anë. Nga ana tjetër për këtë pagesë kompania juaj nuk ka bërë përlogaritjen e tatimit dhe të kontributeve në paga që kape Shumen prej 2.0880.00€ e që do të pasojë me ndeshkime dhe kamata për moslogaritje dhe mosmbajtje në burim të tatimit dhe të kontributeve .

Rekomandimi: Në si auditor ju rekomandojmë që në të ardhmen për çdo pagesë që u bëhet të punësuarëve të bëhet dhe përlogaritja dhe mbajtja në burim të tatimit dhe të kontributeve në paga, dhe në të njëjtin kohë të transferohen në fondet perkatese .

Komentet. Sa i përket ndihmave në seminaret e mbajtur nga ATK-ja jem injoftuar se këto shpenzime që nuk taten nuk pranohen si shpenzime për çështje tatimore përkëtuarsye edhe me telefon (gojarisht) e kamë informuar z.Nijazi Jakupi se këto shpenzime dhe shpenzimet e kamatave, dhe ndihmat nuk janë përfshirë në Deklaratën Vjetore të ATK-ës gjë që mundë të verifikohet sepse në veq e kemi dhënë Deklaratën vjetore të atk-ës.

Ju duhet të jeni në dijeni se kontabiliteti për çështje tatimore I kadi ndryshim nga kontabiliteti I Menaxhmentit.

Rasti 3. Programi kontabilitetit

Gjetja e auditorit: Programi e kontabilitetit –Gjat auditimit auditorët tane duke I kryer testet e auditimit dhe duke bërë verifikimin e sistemit të kontrollit sidomos të Programi I kontabilitetit -PROGRAMI I ASSECOS të cilin e aplikon kompania KRU Mitrovica nga viti 2017 sa i përket faturimit nuk ka vrejtje, ndërsa të puna e kontabiliteti ky program nuk i plotson kushtet minimale- sipas Ligjit për Kontabilitet Raportim Financiar dhe Auditim LIGJI Nr. 06/L- 032 sepse krejt pasqyrat financiare duhet me i përgadite

jashtë programit, moduli i asetëve dhe Zhvlersimin e asetëve nuk është i aplikueshem Ky program Bilancin vertetues nuk e paraqet conform statndardeve si dhe nuk ka mundesi te transferohet ne excel si edhe probleme të tjera te karteleve material dhe financiare.

Ndikimi: Ky program kontabiliteti duke mos qene i kompletuar conform standardeve pamundëson paraqitjen e drejte dhe ne kohe te informacionit financiar te kompanise.

Rekomandimi: Ne re komandojme qe menaxhmenti i kompanise temerr vendim per tu paisur me nje program te kontabilitetit material financiar, icili program do te kete dhe me njeshkalle te larte te besueshmerise conform standardeve te parapara me Ligjin per Kontabilitet Raportim Financiar dhe Auditim.

Komentet e Menaxhmentit :

Letrën e punoi :

Nijazi Jakupi, auditor ligjorë

E rishikoi Haxhi Nimanaj, auditor ligjor

Prill 2020

Kompania Rajonale e Ujësjesit
“ **MITROVICA** ” SH.A.
Mitrovicë

Raport i Audituar financiar

Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2019



Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	2-5
Pasqyra e Gjendjes Financiare	6-7
Pasqyra e të Ardhurave	8
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	9
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë	10-11
Shënime mbi Pasqyrat Financiare	12-25

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e KRU "Mitrovica" SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Kompanisë KRU "Mitrovica" SH.A. të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, përveq çështjes së theksuar Pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Kompanisë me datën 31 Dhjetor 2019, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e njafueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në Shpalosjen 3.6 të pasqyrave financiare, që të ardhurat e pranuar si subvencione në bazë të vendimit nr. 3058 dhe vendimeve paraprake në vitin 2019 MZHE (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) për mbulimin e kostove për ujën e prodhuar, duhet të njihen konform Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit -SNK 20, paragrafët 29, 30 dhe 31.

Të hyrat nga subvencionet njëjt si edhe grantet qeveritare duhet të njihen dhe trajtohen fillimisht si të hyra të shtyra dhe me pastaj paralelisht duke i njohur si të hyra dhe si shpenzime për kostot e qëllimit të subvencionit në periudhat përkatëse.

Opinionin ynë nuk është kualifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në formimin e opinionit tonë mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Ndërsa në këtë rast nuk kemi çështje kryesore të auditimit.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrollin e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku I mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative

Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit


Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KRU "Mitrovica" SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në *Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.*

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e *Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.*

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të KRU "Mitrovica" SH.A. për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2019, më datë 31.10.2019 nga menaxhmenti/aksionarët e kompanisë.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinionin i auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në *UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5* dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

"Audit Check" SHPK


Haxhi Nimanaj, auditor ligjor
Dt .23.04.2020



- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruara, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe përfushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

RAPORTI FINANCIAR VJETOR

Emri i kompanisë: KRU Mitrovica Sh.A.
Numri Unik Identifikues: 810364852
Adresa: Rr. "Bislim Bajgora" p.n. Mitrovicë

**Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2019**

	Shënimi	2019	2018
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3.3	4,278	41,130
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	23,651,068	22,396,024
Stoqet	3.5	261,785	356,094
Instrumentet financiare derivative		-	-
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë		-	-
Pasuritë e klasifikuara si të mbajtura për shitje		-	-
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.4.1	-	-
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		23,917,131	22,793,248
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	3.2	30,720,950	33,047,234
Investimet e mbajtura deri në maturim		-	-
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje		-	-
Investimet e trajtuara sipas metodës së ekuitetit		-	-
Prona investuese		-	-
Investimet në vijim	3.2	140,676	-
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		30,861,626	33,047,234
Gjithsej pasuritë		54,778,757	55,840,482
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	1,163,296	1,288,430
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Tatimet e pagueshme aktuale		3,632,611	3,655,792
Të hyrat e shtyra	3.7.1	21,325,116	22,420,743
Provizionet afatshkurta		-	-
Përfitimet e punonjësive të pagueshme		-	-



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

		15,442	13,972
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër		-	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra	3.7	-	-
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		26,136,465	27,378,937
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	3.7	-	-
Provizionet afatgjata		-	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatgjatë		-	-
Detyrimet e shtyra tatimore		-	-
Përfitimet e punonjësive të pagueshme		-	-
Detyrimet e tjera afatgjata	3.7	-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		26,136,465	27,378,937
EKUITETI			
Kapitali aksionar	3.13	26,490,000	26,490,000
Fitimet e mbajtura	3.13	2,152,292	1,971,545
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej ekuiteti		28,642,292	28,461,545
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		54,778,757	55,840,482

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv




Drejtori financiar/Kontabilisti i
Certifikuar




**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shënimi	2019	2018
Të hyrat	3.6	4,412,352	4,279,238
Kostoja e shitjes	3.9	518,549	516,881
Fitimi / (humbja) bruto		3,893,803	3,762,357
Të ardhurat tjera	3.6	2,324,684	2,109,719
Shpenzimet e shpërndarjes	3.10.2	3,231,061	2,602,118
Shpenzimet administrative	3.10.1	2,601,856	2,462,129
Fitimet/ (humbjet) tjera - neto	3.12	-	-
Fitimi / (humbja) operativ		385,570	807,829
Shpenzimet financiare	3.10.3	204,823	21,785
Të ardhurat financiare		-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		180,747	786,044
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		180,747	786,044
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse: Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:		-	-
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit:		180,747	786,044

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv




Drejtori financiar/Kontabilisti i
Certifikuar




**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali aksonar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2018	26,490,000	1,185,501	-	27,675,501
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	786,044	-	786,044
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2018	26,490,000	1,971,545	-	28,461,545
Gjendja më 1 janar 2019	26,490,000	1,971,545	-	28,461,545
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	180,747	-	180,747
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	26,490,000	2,152,292	-	28,642,292



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shënimi	2019	2018
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		180,747	786,044
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	2,408,937	2,354,453
Te ardhurat nga te Hyrat e shtyera dhe donacionet		-	1,234,500
Te hyrat tjera		-	253,562
Shpenzimet e borxheve te keqija		-	91,369
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		-	-
Të ardhurat financiare	3.6	-	-
Shpenzimet financiare	3.10.1	204,823	21,785
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	3.12	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		2,794,507	1,765,589
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	1,255,044	1,922,368
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	3.5	94,309	142,916
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.4.1	-	-
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	125,134	288,023
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	3.7	1,117,338	159,899
Tatimi në fitim i paguar		-	-
Interesi i paguar		204,823	21,785
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		186,477	163,772
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	223,329	31,079
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		- 223,329	- 31,079



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë	3.13	-	-
Dividendat e paguara		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	3.7	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	3.7	-	-
Pagesat e lizingut financiar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		- 36,852	- 194,851
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3.3	41,130	235,981
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		4,278	41,130



1. Informata të përgjithshme

Kompania e Ujësjetlësi Rajonal "Mitrovica: - Sh.A. - Mitrovicë tutje (KURM) Sh.A. është Shoqëri Aksionare e konstituar me 29 Maj 2007 në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2001/6 të dates 8 Shkurt 2001 "Mbi Ndërmarrjet Afariste" në Kosovë". Kompania u regjistrua në Agjensionin për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare (ARBK) pran Ministrisë për Tregëti dhe Industri (MTI) me datën 31 Maj 2007. Konstituimi i Kompanisë erdhi si rezultat i Projektit për Korporatizimin e sektorit të ujsjetlësve në Kosovë. Kompania si entitet legal në tërësi është pronë varëse e Kompanisë Ujësjetlësi Regjional "Mitrovica" Sh.A. - Mitrovicë e cila është si pasardhëse ligjore e ish Kompanisë Publike "Ujësjetlësi Regional"- Mitrovicë.

Selia e kompanisë është në rrugën "Bislim Bajgora" p.n. 40 000 Mitrovicë.

Kompania me 31 dhjetor 2019 ka 258 të punësuar (31 dhjetor 2018: 243 të punësuar).



Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha, për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

2.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën raportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2019):

- **Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet Financiare**

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi 'Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshime në SNRF 9)' për të adresuar shqetësimet rreth asaj se si SNRF 9 'Instrumentet Financiarë' klasifikon aktivet financiare të veçanta të parapagueshme. Përveç kësaj, BSNK sqaroi një aspekt të kontabilitetit për pasivet financiare pas një modifikimi. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

- **KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat**

KIRFN 23 është lëshuar nga BSNK më 7 qershor 2017 dhe është efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me leje të lejuara më parë.

- **SNRF 16 Qiratë**

SNRF 16 ofron një model gjithëpërfshirës për identifikimin e marrëveshjeve të qirasë dhe trajtimin e tyre në pasqyrat financiare për të dy qiramarrësit dhe qiradhënësit. SNRF 16 do të zëvendësojë udhëzimet aktuale të qirasë duke përfshirë SNK 17 Qiratë dhe interpretimet përkatëse kur të hyjë në fuqi për periudhat kontabël që fillojnë në ose pas 1 janar 2019.

- **Ndryshime në SNK 28 Interesat Afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta**

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi "Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)" për të sqaruar se një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" për interesat afatgjatë në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që formon pjesë e investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, por për të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

- **Ndryshime në SNK 19 Përfitimet e punonjësve Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja**

Më 7 shkurt 2018, BSNK publikoi 'Ndryshimin e Planit, Reduktimin ose Zgjidhjen (Ndryshimet në SNK 19)' për të harmonizuar praktikat kontabël dhe për të dhënë informacion më të rëndësishëm për vendimmarrje. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për ndryshimet në plan, reduktimi ose zgjidhja që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019.



Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha, për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

2.2 Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- **Ndryshimet në fazën e parë të reformës në Librin e Regjistrimeve të Investimeve (IBOR)**
Më 26 Shtator 2019, BSNK lëshoi 'Reformën në Standardin e Normave të Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)' si një reagim i parë ndaj efekteve të mundshme që reforma IBOR mund të ketë në raportimin financiar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit***
Më 22 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përcaktimi i një biznesi (Ndryshime në SNRF 3)' që synojnë zgjidhjen e vështirësive që shfaqen kur një entitet përcakton nëse ka siguruar një biznes apo një grup të pasurive. Ndryshimet janë efektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e përvetësimit është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 *Përkufizimi i Ri i Materialitetit***
Më 31 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)' për të sqaruar përkufizimin e 'materialit' dhe për të lidhur përkufizimin e përdorur në Kornizën Konceptuale dhe vetë standardet. Ndryshimet janë efektive për periudhat të raportimit vjetor që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020.
- **Referencat e Perditësuara në Kornizën Konceptuale**
Së bashku me 'Kornizën Konceptuale' të rishikuar të publikuar në Mars 2018, BSNK lëshoi gjithashtu 'Ndryshime në Referenca të Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF'. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2020.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**
SNRF 17 kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përmbushjes dhe të sigurojnë një qasje më të njëtrajtshme të matjes dhe prezantimit për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë të dizajnuara për të arritur qëllimin e kontabilitetit konstant të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve që nga 1 Janari 2021.
- **Ndryshimet në SNK 1 *Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale***
Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Kompanisë.



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**3 . PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
dhe Shpalosja e Pasqrave Financiare per vitin 2019**

3.1 Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), cila është edhe monedha funksionale për Kompaninë. Euro (€) është valuta kombetare në Kosovë.

3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Toka, Ndertesa dhe Makinerit jane te mbajtura ne pasqyrat e pozicionit financiare ne vleren e tyre te rivlersuara, sipas vlerese se tyre te dates se rivlersimit, zbritur per zhvlersimet e akumuluar dhe te shlyrjeve te munehme. Rivlersimi eshte bere sipas rregullave dhe metodave adekuate sikur qe vlera e mbetur e tyre nuk ka diferenca material nga ato qe do te percaktojne vleren e derjt te tregut ne fund te qdo periudhe.

Per te gjitha asetet e reja si: Prona, impiantet dhe pajisjet janë matur në kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni tabelës Nr. 3.2). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisë vlerësuar të secilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre tëdobishme. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitime të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat ato lidhen.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese :

	2019	2018
Ndertesa	5%	5%
Rrjetet e ujesjllësit	5%	5%
Veturat	20%	20%
Pajimet tjera, kompjutere	20%	20%

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Qiratë e tjera janë qira operative për të cilat pasuritë me qira nuk janë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar të kompanisë. Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në bazë të metodës lineare të afatit të qerasë.

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha, për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

3.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

3.4 Të arkëtueshme dhe kerkesat tjera tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimisht me shumën e arkëtuar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi për borxhet e dyshimta.

3.5 Stoqet

Stoqet janë njohur fillimisht sipas koston ose vlerës së realizueshme neto, varësisht se cila është më e ulët. Kostoja përmban koston e blerjes, koston e shendërimit, dhe të gjitha kostot shoqëruese të ndodhura për të sjellje stoqet në vendin dhe gjendjen aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

3.6 Njohja e të Hyrave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë të përmbushura:

- Kompania ka transferuar tek blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- Kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

3.14 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 06/L -105 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave"
Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha, për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhet në organet tatimore.

3.7 Detyrimet

Një detyrim njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Kompanisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

3.8 Llogarit e pagueshme

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i është faturuar Kompanisë apo jo.

3.7 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet (Huazimet)

Huazimet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare kreditë dhe huazimet janë paraqitur me koston e amortizuar dhe çdo diferencë mes koston dhe vlerës së ripagesës njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përgjatë periudhës së huazimit duke përdorur metoden efektive të interesit.

3.13 Kapitali aksionar

Kapital aksionar i kompanisë me 31 Dhjetor 2019 është EUR 25,000 (31 Dhjetor 2018: EUR 25,000). Rezerva e rivleresimit prej EUR 26,465,000 (31 Dhjetor 2017: EUR 26,465,000) është njohur si diferenca në mes të vlerës reale të pasurive neto dhe vlerës së kapitali fillestar të kontribuar nga aksionaret e kompanisë.

3.10 Shpenzimet e periudhës

Shpenzimet janë njohur në momentin e ndodhjes

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

3.14 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e koston historike në monedhë të huaj nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.15 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stoqeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përketin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

3.16 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.17 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.18 Kontingjentat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur përveq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni është njohur nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

3.19 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

3.20 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare.



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Tabelat:

3.2 Makineritë dhe pajisjet

Kostoja	Toka €	Ndërtesat €	Pajisjet, Veturat, kompjuterët etj €	Investimet ne vijim €	Gjithsej €
Më 1 janar 2019	2,599,006.00	46,305,953.00	4,289,914.00	-	53,194,873.00
Shtesat gjatë vitit	-	-	82,653.00	140,676.00	223,329.00
Më 31 dhjetor 2019	2,599,006.00	46,305,953.00	4,372,567.00	140,676.00	53,418,202.00
Zhvierësimi i akumuluar dhe dëmtimi					
Më 1 janar 2019	-	16,096,945.00	4,050,694.00	-	20,147,639.00
Zhvierësimi vjetor	-	2,315,123.00	93,814.00	-	2,408,937.00
Më 31 dhjetor 2019	-	18,412,068.00	4,144,508.00	-	22,556,576.00
Vlera neto					
Më 31 dhjetor 2019	2,599,006.00	27,893,885.00	228,059.00	140,676.00	30,861,626.00

3.3 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019 €	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018 €
Paraja në arkë	-	3.00
Paraja në bankë	4,278.00	41,127.00
Gjithsej	4,278.00	41,130.00

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.4 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Të arkëtueshmet tregtare – neto	21,226,694.90	22,396,024.00
Blersit me shumic Veriu	14,611,214.10	
Minus (Provizionet nga Llogarite e Arketueshme):	- 12,186,841.00	
Gjithsej llogaritë e arketushme	23,651,068.00	22,396,024.00

Të arkëtueshmet tregtare përfshijnë të arkëtueshme nga klientët e kompanisë për të ardhurat e gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve të mbeturinave.

Edhe provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregëtare gjatë viti 2016 ka qenë 1,198,744 euro. Ndërsa gjatë vitit 2017 provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregtare ka qenë 764.739 euro. Gjatë vitit 2018 provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregtare ka qenë 91,369 euro. Gjatë vitit 2019 provizionimi i të arketueshmeve tjera dhe tregtare ka qenë 550.679 euro.

3.5 Stoqet

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Lënda e parë dhe pjesët rezervë në Depo	375,269.00	469,578.00
Minus (Provizioni) për lëvizje të ngadalshme dhe stoqet e vjetëruara e ato jashtëpërdorimit	(113,484.00)	(113,484.00)
Gjithsej Stoqet	261,785.00	356,094.00

3.6 Te hyrat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Te hyrat nga shitja/shërbimet	4,412,352.00	4,279,238.00
Te hyrat nga subvecionet	1,048,928.81	
Te hyrat tjera	1,275,755.19	2,109,719.00
Gjithsej te hyrat	6,737,036.00	6,388,957.00

Te hyrat e pranuar si subvencione nga Qeveria për vitin 2019 në vlerë prej 1,048,928.81 euro për mbulimin e kostove për ujë të prodhuar i cili është i destinuar për konsumatorët e veriut nuk i kemi njohur konform SNK 20.



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.7 Detyrime

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Detyrime afatshkurtëra		
Obligimi për Tvsh	3,623,039.00	3,647,291.00
Tatimi ne paga l pagueshëm	9,572.00	8,501.00
Kontributi i pagueshëm	15,442.00	13,972.00
Te Hyrat e Shtyera (Grantet) *3.7.1	21,325,116.00	22,420,743.00
Llogaritë e Pagueshme/Furnitorët *3.8	1,163,296.00	1,288,430.00
Detyrime tjera afatshkurtëra		
Gjithsej Detyrimet Afatshkurtëra	26,136,465.00	27,378,937.00
Gjithsej Detyrimët	26,136,465.00	27,378,937.00

3.7.1 Te Hyrat e Shtyera (Grantet)

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Asetet-Grantet para periudhes	22,420,743.00	22,256,556.00
Asetet-Grantet e periudhes	180,128.00	1,398,687.00
Të hyrat e njohura gjatë vitit	(1,275,755.00)	(1,234,500.00)
Gjithsej Te Hyrat e Shtyera	21,325,116.00	22,420,743.00

3.8 Llogaritë e pagueshme tregtare

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	1,163,296.00	1,288,430.00
Gjithsej llogaritë e pagueshme	1,163,296.00	1,288,430.00

3.13 Kapitali aksionar dhe rezerva e rivleresimit

Kapital aksionar i kompanise me 31 Dhjetor 2018 eshte EUR 25,000 (31 Dhjetor 2017: EUR 25,000). Rezerva e rivleresimit prej EUR 26,465,000 (31 Dhjetor 2017: EUR 26,465,000) eshte njohur si diferenca ne mes te vleres reale te pasurive neto dhe dhe vleres se kapitali fillestar te kontribuar nga aksionaret e kompanise.



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.13 Kapitali dhe Rezervat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Kapitali themelues	25,000.00	25,000.00
Rezervat e Rivleresimit	26,465,000.00	26,465,000.00
Fitimet/(Humbjet) e bartura ne filim te vitit	1,971,545.00	1,185,501.00
Fitimi/(Humbja) e vitit	180,747.00	786,044.00
Gjithsej ekuiteti	28,642,292.00	28,461,545.00

3.10.1 Shpenzimet Administrative

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Shpenzimet e Energjis Elektrike	680,241.00	666,775.00
Shpenzimet e Zyres	20,136.00	85096
Shpenzimet e perfaqsimit	7,278.00	6,329.00
Shpenzimet e Telefonit dhe Internetit	6,115.00	5,391.00
Gjithsej shpenzimet administrative	713,770.00	763,591.00
Shpenzimet Pagave	1,888,086.00	1,698,538.00
Gjithsej Shp.Adm. dhe Shp e Pagave	2,601,856.00	2,462,129.00

3.10.2 Shpenzimet e Shperndarjes

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Shpenzimet e Karburanteve	27,844.00	30,236.00
Shpenzimet e Transportit	875.00	1,266.00
Shpenzimet e Qerases	19,866.00	17,378.00
Shpenzimet e Sigurimit / Regjistrimit	4,635.00	10,728.00
Shpenzimet e Mirmbajtjes /Servisimit	131,554.00	162,435.00
Shpenzimet e Zhvlersimit	2,408,937.00	2,354,453.00
Shpenzimet tjera te shperndarjes	637,350.00	25,622.00
Gjithsej shpenzimet e shperndarjes	3,231,061.00	2,602,118.00

3.10.3 Shpenzimet financiare

	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2018
	€	€
Shpenzimet e interesit nga lizingu financiar	204,823.00	21,785.00

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Gjithsej	204,823.00	21,785.00
-----------------	-------------------	------------------

4. Vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut

4.1 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualet, të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

4.2 Menaxhimi i rrezikut

Aktivitetet e Kompanisë e ekspozojnë atë në një shumëllojshmëri të rreziqeve financiare, duke përfshirë:

- (a) rreziku kreditor
- (b) rreziku i likuiditetit
- (c) rreziku i tregut

4.2.2 Rreziku i kredisë

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe të parave të gatshme. Ekspozimi i Kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termet dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tilla.

Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë. Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës
Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe, kohë pas kohe, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për tu mbrojtur plotësisht nga ajo.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

4.2.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që një njësi ekonomike do të ndeshë vështirësi në plotësimin e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimin të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

Në vijim janë maturimet kontraktuale të detyrimeve financiare, duke përjashtuar ndikimin e marrveshjeve mbi kompenzimin:

	Më pak se 1 muaj	1 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vite	Gjithsej
31 dhjetor 2018				
Pasuria				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	41,130	-	-	41,130
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	-	22,396,024	-	22,396,024
Gjithsej pasuria	41,130	22,396,024	-	22,437,154
Detyrimet				
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	1,288,430	-	-	1,288,430
Detyrimet afatgjata	22,420,743	-	-	22,420,743
Llogari te pagueshme tatimore	-	3,669,764	-	3,669,764
Gjithsej detyrimet	23,709,173	3,669,764	-	27,378,937
Pozicioni i likuiditetit	(23,668,043)	18,726,260	-	(4,941,783)
Hendeku i likuiditetit neto	(23,668,043)	(4,941,783)	(4,941,783)	
31 dhjetor 2019				
Pasuria				
Paraja dhe ekuivalentet e saj	4,278	-	-	4,278
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	-	23,651,068	-	23,651,068
Gjithsej pasuria	4,278	23,651,068	-	23,655,346
Detyrimet				
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	1,163,294	-	-	1,163,294
Detyrimet afatgjata	21,325,116	-	-	21,325,116
Llogari te pagueshme tatimore	-	3,648,053	-	3,648,053
Gjithsej detyrimet	22,488,410	3,648,053	-	26,136,463
Pozicioni i likuiditetit	(22,484,132)	20,003,015	-	(2,481,117)
Hendeku i likuiditetit neto	(22,484,132)	(2,481,117)	(2,481,117)	



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të KRU "Mitrovica" Sha,
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

4.2.4 Rreziku i Tregut

a) Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranoen dhe shpenzohen në Euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

b) Ekspozimi ndaj rrezikut të normes së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut duke pasur parasysh se shumica e financimit sigurohet nga kompania mëmë.

Palët e lidhura

Palët konsiderohen si të lidhura nëse njëra palë e ka aftësinë të kontrollojë ose ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me kompanisë.

Në palët e lidhura përfshihet askionari dhe personeli kyç në menaxhimin e kompanisë. Transakcionet me aksiorin (Ministria e Zhvillimit Ekonomik) dhe kompenzimet e menaxhmentit për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019 janë si vijon:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
<i>Transakcionet</i>		
Minsitria e Zhvillimit Ekonomik	1,048,929	580,000
<i>Kompenzimi për menaxhmentin</i>		
Menaxhmenti kyç	-	-
Bordi drejtoreve	26,521	42,655

Zotimet

Më 31 dhjetor 2019, Kompania nuk ka pasur zotime.

Detyrimet kontingjente dhe provizionet

Me 31 dhjetor 2019 Kompania është e përfshirë në çështje gjyqësore nga aktiviteti normal i biznesit si pale e paditur. Si me 31 dhjetor 2019 kompania nuk ka njohur ndonjë detyrim për rastet gjyqësore të mundshme për tu humbur.

Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar që kërkon korrigjime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date / / .

